



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “PRODHIME DRURI GJYSMË
TË GATSHME”

(Niveli III në KSHK¹, referuar Niveli III në KEK²)

Kodi: C2-III-23

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Programi orientues për provimet përfundimtare kualifikimit profesional “**Prodhime druri gjysmë të gatshme**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individëve në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësimdhënësit të zhvillojnë teste të individëve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t’i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e individëve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Prodhime druri gjysmë të gatshme**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë rreth 35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përzgjedhur për t’u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat për secilën prej tyre, janë si më poshtë.

Lënda dhe pesha përkatëse në programin orientues:

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri	16	19

2	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri	27	32
3	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri	42	49
	TOTALI	85	100

1) Temat nga lënda “**Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri**”, kl. 12:
(16 orë)

Tema 3	Metodat e sharrimit të trupave	5 orë
Tema 4	Makina gatër	5 orë
Tema 7	Makina sharrë shirit dhe disk për trupa	4 orë
Tema 8	Instrumente prerës të sharrimit dhe mirëmbajtja e tyre	2 orë

2) Tema të lëndës “**Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri**”, kl. 12:
(27 orë)

Tema 2	Lënda e parë për prodhimin e rimesos dekorative dhe teknike	9 orë
Tema 6	Prodhimi i rimesos dekorative, makinat strugane	6 orë
Tema 8	Teknologjia e prodhimit të fletëve të rimesos teknike	5 orë
Tema 10	Teknologjia e prodhimit të kompensatës	7 orë

3) Tema të lëndës “**Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri**”, kl. 12:
(42 orë)

Tema 1	Teknologjia e prodhimit të pllakave prej zdrukthi	2 orë
Tema 3	Prodhimi i ashklave, zdrukthit dhe depozitimi i tij	5 orë
Tema 5	Formimi i qilimit të pllakës prej zdrukthi	6 orë
Tema 7	Teknologjia e prodhimit të pllakës së fibrës	2 orë
Tema 9	Defibrimi i ashklave, përpunimi i fibrave me kimikate	5 orë
Tema 10	Formimi i qilimit me fibra	4 orë
Tema 12	Mënyra të tjera të fabrikimit të pllakës së fibrës, M.D.F.	4 orë
Tema 13	Teknologjia e prodhimit të pllakës panel dhe qelizore	8 orë
Tema 14	Përpunimi përfundimtar, marketimi, paketimi magazinimi	6 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 orë dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtete e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve:

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri	19	11	4	4	3
2	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri	32	20	8	8	4
3	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri	49	29	12	12	5
TOTALI		100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrohen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit pikë-notë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6

21 – 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin **”Prodhime druri gjysmë të gatshme”, Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK,** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë janë si më poshtë:

Nr.	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të kryejë punime në depozitën e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatshme.	Detyra 1: Punime në depozitën e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatshme. Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës në depozitën e lëndës së parë kur 1. Përgatit vendin e punës 2. Kryen procese pune për matjen, klasifikimin, ruajtjen dhe trajtimin e lëndës së parë.	20
2.	Të kryejë përpunimin mekanik i drurit	Detyra 2: Përpunimi mekanik i drurit Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës për punime kur 1. Përgatit vendin e punës 2. Kryen punime të sharrimit të trupave në makinat gatër, sharra shirit, rrethore dhe motosharra 3. Kryen punime të prerjes plane të prizmave dhe tornimit të trupave në makinat strugane e torno. 4. Kryen punime të copëtimit, bluarjes, defibrimit dhe rafinimit të drurit në makinat përkatëse.	20
3.	Të kryejë punime tharje, lyerje me lëndë ngjithëse dhe kimikate.	Detyra 3: Punime tharje, lyerje me lëndë ngjithëse dhe kimikate. Vlerësimi i një ose më shumë proceseve të punës në tharje, lyerje me lëndë ngjithëse dhe kimikate kur: 1. Përgatit vendin e punës 2. Kryen punime për seleksionimin e lëndës drunore.	20

		3.Kryen punime për tharjen e fletëve të kompensatës, rimesos, ashklave, zdrukthave, fibrave 4. Kryen punime të lyerjes me lëndë ngjitëse të fletëve të rimesos, ashklave, zdrukthave, fibrave etj.	
4.	Të kryejë punime formimi dhe presimit i pllakës së njomë.	Detyra 4: Punime formimi dhe presimit i pllakës së njomë. Vlerësimi i një ose më shumë proceseve të punës të formimit dhe presimit të pllakës së njomë kur: 1.Përgatit vendin e punës 2. Kryen punime të formimit të pllakës së njomë si kompesatë, dru i shtresuar, panel, pllakë qelizore, pllakë zdrukthi, pllakë fibre. 3. Kryen punime presimi për pllaka të njoma druri gjysmë të gatshme	20
5.	Të kryejë punime përfundimtare për prodhimeve druri gjysmë të gatshme	Detyra 5: Punime përfundimtare për prodhimeve druri gjysmë të gatshme. Vlerësimi i një ose më shumë proceseve të punimeve përfundimtare për prodhime druri gjysmë të gatshme kur: 1. Përgatit vendin e punës, 2. Kryen punime të njomjes së pllakave të zdrukthit, fibrës 3. Kryen punime të rimesimi, patinimit, ngjyrimit, lustrimit të pllakave. 4. Kryen punime markëtimi, ambalazhimi dhe magazinimi të prodhimeve druri gjysmë të gatshme.	20
Shuma			100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “*detyra pune*”, në repartin e zdrukthëtarisë (në sektorin e makinerisë dhe montimit).

Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.

Për realizimin e detyrave duhet të vihen në dispozicion katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në detyrë.

Gjatë realizimit të detyrave duhet të kërkohet zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.

Në çdo detyrë janë grupuar objekte me procese pune të njëjta dhe shkolla, sipas kushteve që ka është e lirë të bëjë organizimin e saj.

Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë vlerësimit të bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Gjithashtu, në listën e kontrollit të përfshihen edhe kritere të vlerësimit të kompetencave kyçe (të përgjithshme), në varësi të llojit të detyrës që do të kryhet.

Realizimi i **Detyrës 1: Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës për “Punime në depozitën e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatshme”**

Nxënësi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune si: (shkarkimi i lëndës së parë në depozitë, seleksionimi i saj, matja e lëndës së parë me mjetet përkatëse, si trupa, dërrasa, mbeturina të rimesos, kompensatës nga skuadrimin, koka trupash, degë voza etj. Sistemimi, stivimi i lëndës sipas rregullave në depozitë, ruajtja e lëndës drunore për rezervë dimërore, në basene të posaçme, me shi artificial etj. Të kryejë skuadrimet e nevojshme të kokave të trupave për kompensatë, të kryejë heqjen e lëvores me mjete përkatëse, të kryejë centrimin e trupave, të kryejë trajtimin termik të trupave për rimeso dhe kompensatë sipas një rregjimi të caktuar. Të skuadrojë aniet dhe listelat në funksion të gojës ushqyese të makinave të copëtimit në ashkla duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së ambientit. Kjo detyrë realizohet në depozitat e lëndës së parë të reparteve për realizimin e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri, si lëndë e sharruar, rimeso, kompensatë, dru i shtresuar pllakë zdrukthi, fibre, panel dhe qelizore.

Nxënësi i vihet në dispozicion depozita e lëndës së parë, mjete për shkarkim, pajisje matëse dhe kontrolluese, mjete për heqjen e lëvores, centrimin, makina skuadruese, basene të ruajtjes, basene të trajtimit termik, lëndë e parë për repartin përkatës, si (trupa, binarë druri), mbetje etj., skica të ndryshme që i shërbejnë prerjes në makina, katalogë, manuale, udhëzues.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej proceseve të punës në depozitë. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 2: Vlerësimi i një ose shumë proceseve të punës për “Përpunimin mekanik të drurit”**

Nxënësi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune si: (të përgatisë makinat për punë dhe të punojë në makinat gatër, në sharre shirit, disk të prerë trupat në dërrasa (lëndë e sharruar). Të punojë në makina strugane me prizma druri të përgatitura për të realizuar rimeso dekorative me trashësinë e kërkuar, makina torno për rimeso teknike, makina gërsërë për skuadrimin e fijeve të rimesos. Të punojë në makinat e copëtimit të drurit për zdrukthe dhe ashkla, në makinat e defibrimit për të fituar fibra sipas standartit. Të punojë në makinat bazë të përpunimit të drurit për përgatitjen e mesit të pllakave panel etj.

Kjo detyrë realizohet në një repartet e makinerisë për realizimin e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri.

Nxënësit i vihet në dispozicion makina, lëndë e parë (trupa, binarë druri), skica të ndryshme që i shërbejnë prerjes në makina, katalogë, manuale, udhëzues, skica e skemës së procesit teknologjik të repartit të prodhimit të pllakës panel, kompleti i veglave.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej proceseve të punës për përpunimin mekanik të drurit në repartet e realizimit të prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 3: Vlerësimi i një ose më shumë proceseve të punës në “Punime tharje, lyerje me lëndë ngjitëse dhe kimikate”**

Nxënësi duhet të testohet për një proces ose më shumë procese pune si: (të përgatisë dhe të punojë në makinat tharëse në repartin përkatës si për tharjen e rimesos teknike, tharjen e ashklave dhe zdruktheve, tharjen e fibrave të druri etj. sipas lagështisë përfundimtare të kërkuar, të kryejë tharjen natyrore të rimesos dekorative etj. Të përgatisë lëndën ngjitëse dhe kimikate të tjera të nevojshme, të furnizojë makinat përkatëse të lyerjes dhe të punojë në sektorin përkatës si për rimeso, kompensatë, për ashkla, fibra, për rripa druri të pllakës panel etj. Të kujdeset për makinat dhe mjetet e tharjes dhe lyerjes.

Nxënësit i vihet në dispozicion mjedisi i sektorit të lyerjes dhe tharjes me mjetet dhe makinat përkatëse, lënda e parë drunore, lënda ndihmëse (kimikatet përkatëse) skica të ndryshme makina, katalogë, manuale, udhëzues, kompleti i veglave.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej proceseve të punës në tharjen dhe lyerjen me kimikate të lëndës së parë specifike. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 4: Vlerësimi i një ose më shumë proceseve të punës në “Punime formimi dhe presimi i pllakës së njomë ”**

Nxënësi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune si: në pllakën e kompensatës, drurin e shtresuar, pllakën panel apo qelizore, të përgatitë platformën ose bazën mbas makinës së lyerjes, të kryejë punime formimi sipas numrit të shtresave të rimosos dhe mënyrës së vendosjes së tyre, modelit të mesores së panelit etj. Të përgatitë makinat në linjën e formimit dhe të punojë për formimin e pllakës së njomë me zdrukthe apo fibra duke zbatuar parametrat. Të zgjedhë dhe të përgatitë presën për punë dhe të punojë në presa sipas rrëgjimit të caktuar. Të punojë për shkarkimin e presës me ashensorin përkatës dhe përcjelljen e pllakës në procese të tjera.

Nxënësit i vihen në dispozicion mjedise të repartit me pajisjet dhe makinat e formimit të pllakës së njomë si dhe sektorë të presimit me presat përkatëse, katalogë, manuale, udhëzues, kompleti i veglave.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej proceseve të punës në formimin dhe presimin e pllakës së njomë. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në procesi/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 5: Vlerësimi i një ose më shumë “Proceseve përfundimtare për prodhime druri gjysmë të gatshme”**

Nxënësi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune si: (të kontrollojë produktin sipas standardit, të kryejë aklimatizimin e pllakës së përfunduar në magazinë me një rregjim të përcaktuar sipas standardit, të kryejë njomjen e pllakës së fibrës me makinën përkatëse, të kryejë skuadrimet sipas standardit, në makinat përkatëse që mund të jenë dhe të avancuara, të kryejë kalibrimin e pllakës për të marrë trashësinë e kërkuar, të kryejë markëtimin e pllakave sipas parametrave, të kryejë punime të ambalazhimit e monitorojë etiketimin e ambalazhimit, të kryejë magazinimin e punimeve të ambalazhuara sipas standardit.

Nxënësve u vihen në dispozicion mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për procesin e rimesimit, lustrimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve të tyre, kompletimi i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procesin e rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve të tyre, skica të proceseve, lëndë e parë, katalogë, manuale, udhëzues.

Të markëtojnë pllakën sipas kërkesave, të kryejë ambalazhimet e nevojshme, të kryejë etiketimet dhe të magazinojnë produktin sipas rregullave duke pasur parasysh parametrat e duhura të ajrit në magazinë.

Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.